Mësimi i misionit

Viti i 3-të – Tremujori i 3-të

Qëllimi: T'u prezantojmë nxënësve punën misionare mjekësore dhe t'i inkurajojmë të luten për ata që janë të përfshirë.

Mjetet dhe ambienti:

- Lapustila në ngjyrat: e kuqe, e gjelbër dhe blu, për të shënuar duart e fëmijëve
- Një hartë e botës
- Mjetet për infermierin: syze dhe një kartelë
- Mjetet për doktorin: përparëse dhe stetoskop
- Tre shishe boshe (që përfaqësojnë mjekimet dhe vitaminat)
- Tre ftesa për një shërbesë në kishë (mund të jetë ftesë e vërtetë ose jo)
- Ndaje klasën në tre ambiente të ndryshme: dhoma e pritjes (vendos karriget për nxënësit), dhoma e ekzaminimit (vendos një përparëse dhe një karrige) dhe farmacia (vendos shishet boshe në një tavolinë)

Mënyra për t'i dhënë "energji" mësimit të misionit:

- Në vend që të gjitha rolet t'i luajë një person, përfshi disa njerëz në këtë mësim (njëri të jetë doktori, tjetri infermieri dhe një tjetër rrëfimtari/mësuesi).
- Përfshi dekor peruan te hapësirat e "klinikës" (ngjyra të ndezura, flamuri peruan, etj.)
- Një kryq në mur që tregon se klinika gjendet në një kishë peruane.

Shënim për drejtuesin: Gjatë mësimit do të zgjedhës tri nxënës që do të "vizitohen" nga doktori në klinikë. Që të mos ketë rrëmujë, mund t'i zgjedhësh paraprakisht nxënësit dhe t'i përgatisësh, ose zgjidh tre ndihmës që të hiqen si pacientë.

Mësimi:

Udhëzime për drejtuesin e "Kohës së zbulimit" – para se të hyni në hapësirën e misionit: Bëju shënim fëmijëve te dora para se të nisë mësimi, që të ndahen në tre grupe sipas tre ambienteve të krijuara.

Para se të hyni në dhomën e pritjes, thuaju nxënësve: Sot do të bëjmë sikur jetojmë në një vend të quajtur Peru! Trego Perunë te harta e botës. Ju po prisni me durim të merrni ndihmë në një klinikë mjekësore. Ka vende në botë ku njerëzit nuk kanë para për t'u vizituar te doktori, ose nuk ka mjaftueshëm doktorë, kështu që doktorë dhe infermierë nga vende të tjera udhëtojnë për të krijuar një klinikë të përkohshme dhe për të ndihmuar njerëzit. Shumë gjë e mirë, apo jo? Le të drejtohemi te klinika dhe të shohim ç'bëhet!

Një infermier në dhomën e pritjes: *Drejtuesi i misionit duhet të marrë objektet e infermierit dhe t'i mirëpresë nxënësit në dhomën e pritjes.*

Mirë se erdhët në klinikën tonë! Skuadra jonë mjekësore është gati t'ju ndihmojë, por ende jemi skuadër e vogël, dhe ju jeni të shumtë në numër. Na duhet ndihma juaj për ta bërë më të lehtë. Shikoni dorën – ngjyra që keni tregon për simptomat tuaja (për çfarë keni nevojë). Gjeni personat që kanë të njëjtën ngjyrë në shenjën e dorës dhe uluni pranë njëri-tjetrit këtu në dhomën e pritjes.

Jepu 30 sekonda që të ndahen në grupe; ndihmo sipas nevojës.

Më lejoni t'ju tregoj klinikën. Tani jeni në dhomën e pritjes. Kur t'ju vijë radha për vizitën te doktori, do të hyni te dhoma e ekzaminimit. Nëse do të keni nevojë për mjekime, do t'i merrni te farmacia.
Oh! Doktori është gati! *Zgjidh tre nxënës (një për çdo grup) që të qëndrojnë te dera e dhomës së ekzaminimit.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Doktori në dhomën e ekzaminimit: *Përdor objektet e doktorit. Ftoje nxënësin me shenjën e gjelbër në dorë të vijë te dhoma e ekzaminimit.*

Përshëndetje! Si e ke emrin? Oh, shoh që ke një irritim te krahu. Pa ta shoh njëherë! Ekzamino krahun. Po, siç mendova: duket se ke një infeksion lëkure. Kam lajm të mirë për ty! Farmacia ka një krem që do të të ndihmojë. Nëse do ta aplikosh çdo ditë te krahu, do të shërohet shpejt. Para se të largohesh, a mund të lutem për ty? *Lutuni shkurtimisht së bashku, pastaj dërgoje nxënësin te farmacia.*

Nëse keni kohë, përsërite të njëjtën gjë me dy nxënësit e tjerë:

- *Shenja e kuqe: dhimbje stomake (parazitë intestinal; shkruaj një recetë)*
- *Shenja blu: kollë e thatë (ftohje; rekomando vitamina)*

Infermieri te farmacia: *Përdor mjetet e infermierit te farmacia.*

Ja ku e ke! Ndiq udhëzimet e doktorit dhe do të ndihesh më mirë shumë shpejt. *Jepu shishet boshe.*

Para se të largoheni, dua t'ju ftoj të na bashkoheni për shërbesën e kishës nesër, po në këtë ndërtesë. *Shpërndaju ftesat.* Shërbesa është në 9 të mëngjesit (*mund të vendosësh edhe orarin e saktë të shërbesës tuaj të dielën)*. Do të gëzoheshim shumë po të na bashkoheshit.

Drejtuesi i misionit në dhomën e pritjes: Edhe pse kjo ishte një klinikë e inskenuar – sepse nuk jemi vërtet në Peru dhe unë nuk jam as infermier e as doktor – klinika të tilla ka në të gjithë botën! Doktorë dhe infermierë ndihmojnë njerëz dhe u flasin për Jezusin! Ata e bëjnë këtë sepse e duan Jezusin dhe duan të ndajnë dashurinë e Tij me të tjerët. Këto klinika nuk janë vetëm për ilaçe – ato janë një mënyrë për të treguar dashurinë e Perëndisë dhe për t'i ftuar njerëzit që të mësojnë më shumë për Të.

Jo të gjithë misionarët shkojnë në vende të tjera – disa shërbejnë duke vizituar për një periudhë të shkurtër. Udhëtimet afatshkurtra të misionit u mundësojnë njerëzve të përdorin aftësitë e tyre për t'i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve. A e dini se Perëndia mund t'i përdorë pasionet tuaja? Po, Ai vërtet mundet. Siç e keni parë, në punën misionare mjekësore, doktorët dhe infermierët përdorin aftësitë e tyre për t'u kujdesur për njerëzit. Duke i ndihmuar ata u tregojnë për dashurinë dhe shpresën e Jezusit! Një ditë Perëndia mund të të thërrasë ty që t'i përdorësh aftësitë e tua në një udhëtim misioni afatgjatë ose afatshkurtër!

> *Diskutim shtesë (nëse keni kohë):* Ndoshta ti po pyet veten – A mund të më thërrasë Perëndia që një ditë të shkoj në një udhëtim misioni mjekësor? Nëse mendon se Perëndia mund të të udhëheqë në atë drejtim, mund të flasësh me Të tani. Një lutje e thjeshtë si: "Perëndi, unë do të shkoj kudo dhe kurdo që të duash ti," është fillim i mbarë. Ndërsa rritesh, vazhdo lexo Biblën dhe kërkoji Perëndisë të të tregojë se si do Ai që ti të shërbesh. Nëse të pëlqen shkenca apo të ndihmosh të tjerët, ndoshta Perëndia mund të të drejtojë të studiosh mjekësi dhe të bëhesh doktor apo infermier. Një ditë, ti mund të jesh doktori apo infermieri që shërben në një udhëtim misioni mjekësor, duke u treguar njerëzve nëpër botë dashurinë e Perëndisë!

Çfarë mund të bëjmë tani për të ndihmuar? Mund të lutemi. Aktiviteti i sotëm ishte inskenim mirëpo, ka mijëra njerëz nëpër botë, jo vetëm në Peru, që kanë nevojë për kujdes mjekësor dhe që të dëgjojnë Lajmin e Mirë për Jezusin.

Ndaji nxënësit në grupe me nga tre persona; caktoji secilit një pikë lutje nga të mëposhtmet. Jepu kohë disa minuta të luten në grupe pastaj lutu ti për ta përmbyllur.

Kërkesat për lutje:

1. **Për misionarët mjekë** që ndihmojnë të sëmurët dhe u flasin për Jezusin.
2. **Për të sëmurët**, që të shërohen e të kthehen në kishë për të mësuar më shumë për Jezusin.
3. **Për më shumë doktorë dhe infermierë** që të shkojnë në udhëtime afatshkurtra misioni për të ndihmuar njerëzit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association